



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.110/1Prot.

Tiranë, më 22.01.2019

V E N D I M

Nr. 11, Datë 22/01/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 161, datë 15.10.2018, e Znj. S. G., ku pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore” dhe “aftësisë së kufizuar”¹ nga ana e Z. R.R. dhe Z. R.L., mjekë specialistë pranë Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Publik Korçë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, rezulton se ankuesja është nënë e një vajze 6-vjeçare, që vuan nga sindroma down. Mjekët pranë QSUT-së, Tiranë, kanë diagnostikuar nivelin e sëmundjes së hemofilisë tek pacientja M. G. dhe kanë dhënë rekomandimet përkatëse për përfitim kujdestarie. Në Rekomandimin e lëshuar në datën 12.04.2018, nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, përcaktohet: “.....I rekomandoj të mbështetet me terapi zhvillimi dhe të shihet mundësia e një mësuesi ndihmës në kopësht. Të jetë nën kujdestarinë e vazhdueshme të prindërve”, fakt që lë të kuptohet qartësisht se fëmija nuk është në gjendje të kujdeset për veten dhe është e nevojshme caktimi i shërbimit të kujdestarisë.

Në Epikrizën Përcjellëse për Invalidë, me Nr. Regjistri 720, datë 12.04.2014, lëshuar nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, përkatësisht në Rubrikën “*Diagnoza*” është shënuar: “*Morbus Down.....Prapambetje mendore e moderuar në të rëndë*”. Në Rubrikën

¹ Referuar Rekomandimit të lëshuar në datën 12.04.2018, nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë dhe Epikrizës Përcjellëse për Invalidë, me Nr. Regjistri 720, datë 12.04.2014, rezulton se fëmija i ankueses vuan nga sindroma down.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

“Zbatimi i këshillave mjekësore për mjekim dhe aftësim”, të Epikrizës, citohet: *“...T’i jepet KEMP-i me asistencë prindërore”*. Në Vendimin nr. 36007, datë 17.05.2017, KMCAP Korçë ka përcaktuar diagnozën *“prapambetje mendore e moderuar S. Down”* për Maria S.G..

Ankuesja pretendon se dokumentacioni i sipërpërmendur, sikurse edhe akte të tjera, që vërtetojnë gjendjen e fëmijës së saj, janë dorëzuar pranë Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Publik Korçë, ndërkohë që mjekët specialistë R.R.dhe R.L. nuk e pranojnë Epikrizën e lëshuar nga QSUT me termin *“Prapambetje mendore e moderuar në të rëndë”*, por kërkojnë përdorimin e terminologjisë *“Prapambetje mendore e thellë”*, në mënyrë që fëmija e ankueses të përfitojë shërbimin dhe pagesën e kujdestarisë. Sipas ankueses, ky fakt kundërshtohet nga mjekët e QSUT-së, pasi terminologjia është e njëjtë, ndaj për këtë arsye vajzës 6 vjeçare duhet t’i jepet menjëherë pagesa e kujdestarisë. Për sa më sipër, ankuesja pretendon se në muajin shtator 2018, ka depozituar ankesë pranë Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Publik Korçë, por nuk i është kthyer përgjigje. Znj. S.G. ka pothuajse 6 muaj që endet zyrove përkatëse, pa gjetur zgjidhje për problemin e saj.

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 161, datë 15.10.2018, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Z. R.R.dhe Z. R.L., mjekë specialistë pranë Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Publik Korçë dhe Drejtuesit të Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Publik Korçë me shkresën nr. 1321/1, datë 01.10.2018, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
 - Informacion mbi kriteret që duhen plotësuar për të përfituar pagesë kujdestarie, nga personat me aftësi të kufizuara. Të përcillet pranë Komisionerit, akti që i parashikon shprehimisht këto kriteret;
 - Informacion, nëse mbi bazën e dokumentacionit të depozituar pranë institucionit tuaj nga ankuesja, fëmija i saj i plotëson kriteret për të përfituar pagesë kujdestarie;
 - Nëse kriteret plotësohen, të pasqyrohen qartësisht arsyet, përse nuk është proceduar për përfitimin e pagesës së kujdestarisë për vajzën e Znj. S.G.;

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”*.

- Informacion nëse Znj. S.G. ka depozituar ankesë pranë Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Publik, Korçë. Nëse po, të përcillet pranë Komisionerit një kopje e kërkesës së ankueses, si dhe kopje e përgjigjes zyrtare të dërguar nga institucioni juaj.
- Çdo informacion tjetër që ka lidhje me çështjen e parashtruar nga ankuesja.

Shkresa e sipërpërmendur iu dërgua për dijeni edhe Znj. A. F., Drejtore e Përgjithshme i Institutit i Shëndetit Publik, Znj. S. T., Mjeko Psikiatre për Fëmijë, si dhe ankueses.

1. Në përgjigje të shkresës nr.1321/1, datë 01.10.2018, të Komisionerit, Institutit i Shëndetit Publik ktheu përgjigjen nr. 1438/1, datë 24.10.2018, në Roland Lalaj Roland Lalaj ëpërmjet së cilës e informon KMD-në se çështja nuk është pjesë e aktivitetit të punës së këtij institucioni.
2. Në përgjigje të shkresës nr.1321/1, datë 01.10.2018, të Komisionerit, Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik Korçë dërgoi shkresën nr. 716, datë 24.10.2018, nëpërmjet së cilës e ben më dije KMD-në se Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Korçë ka në strukturën e saj edhe Qendrën Komunitare të Shëndetit Mendor Korçë, ku punon mjeku psikiatër R.L.. Kjo Qendër mbulon personat me problem të shëndetit mendor të Qarkut Korçë dhe deri më sot ka 3004 pacientë të kartelizuar.

Në vijim, ky institucion e bën më dije KMD, se prindërit e fëmijës Maria S.G. janë paraqitur për herë të parë në QKSHM Korçë, në datën 24.04.2017, për të përsëritur vazhdimin e ndihmës ekonomike të akorduar më parë nga KMCAP Korçë. Para kësaj date, ndjekjen dhe përsëritjen e grupit të invaliditetit e ka realizuar shërbimi i neuropediatrisë pranë Spitalit Rajonal Korçë. Pranë këtij institucioni është hapur kartelë për Maria S.G., në datën 24.04.2017 dhe janë arkivuar në kartelë, një vendim i KMCAP Korçë me diagnozën “Sindrom Gjenetik Trisomia 21”, Sindrom Dawn et Hypotireoai, me shënim përfitim ndihme ekonomike për një vit (grupi II). QKSH Korçë e ka vlerësuar fëmijën Maria S.G., me diagnozën “*Prapambetje mendore e moderuar e rëndë*”, Sindromi Dawn dhe kjo diagnozë është dërguar në KMCAP Korçë për vendimmarrje. Pranë KMCAP Korçë janë atashuar disa mjekë specialistë, të cilët marrin vendimin për grupin e invaliditetit dhe në bazë të Vendimit nr. 618, datë 07.09.2006, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara*”, për M. G. është përcaktuar që bën pjesë në grupin II, të invaliditetit.

Në shkresën e Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Publik Korçë theksohet fakti se pranë QKSHM Korçë nuk është depozituar epikriza përcjellëse për invalidë me nr. Regj. 720, datë 12.04.2014, lëshuar nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, ku M. G. është vlerësuar me “*DG Morbus Dawn, prapambetje mendore e moderuar e rëndë*”, me rekomandimet përkatëse për t’i dhënë kemp dhe asistencë mjekësore.

Ky institucion thekson faktin se në dijeninë e tyre, diagnoza “*prapambetje mendore e moderuar e rëndë*”, përfshihet në grupin e dytë të invaliditetit. Njëkohësisht, pranë KMD-së është dërguar

edhe përgjigja e datës 17.10.2018, e Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë Korçë drejtuar Znj. S.G., ku sqarohet lidhur me çështjen në fjalë.

- C. Në vijim të ndjekjes së procedurave hetimore, Komisioneri vendosi të realizojë një seancë dëgjimore, në datën 07.01.2019, ora 11:00. Kjo seancë u anulua, pasi në datën 04.01.2019, ankuesja paraqiti pranë Komisionerit, kërkesë me shkrim, nëpërmjet së cilës tërhiqte ankesën e saj ndaj dy mjekëve të Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Publik Korçë. Ankuesja e bën me dije KMD-në se do ta ankimojë Vendimin nr. 3631, datë 05.12.2018, e KMCAK Korçë⁴ pranë KMCAK Epror në Tiranë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 17 dhe nenin 94, pika 1, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Përfundimin e procedurës së shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 161, datë 15.10.2018, e Znj. S.G., pasi kjo e fundit ka depozituar pranë KMD-së, kërkesë për tërheqje të ankesës.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – te mira dhe shërbime
Shkak - “gjendja shëndetësore” dhe “aftësia e kufizuar”

⁴ Nëpërmjet Vendimit nr. 3631, datë 05.12.2018, të KMCAK Korçë, Maria S.G. nuk e përfiton shërbimin e kujdestarisë, duke u cilësuar si invalide e grupit të dytë, por përfiton ndihmë ekonomike për 1 (një) vit.